



KONFIDENT

Rr.Mine Peza
Tel.+355 04 22 14 800
www.konfident.al
E-mail: info@konfident.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONFIDENT
ORTAKU I VETËM
Nr. 1 PROT.

Tiranë , më 13.02.2020

AKT-THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE "Konfident"- Sh.p.k.

Mbështetur në ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.R" i ndryshuar, me vullnetin e tij të lirë dhe të shprehur Ortaku i vetëm Z.Kristi Dushi i datëlindjes 22.01.2001 ,dhe banues në Adresën Rr.Ferit Xhajko, Pall.63/1 , Sh.5 ,Ap.44 Tiranë, madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të krijojë Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar " Konfident" sh.p.k me Akt- themelimi si vijon:

NENI 1

- 1.1 Formohet shoqëria me Përgjegjësi të kufizuar "**Konfident**" Sh.p.k..
- 1.2 Shoqëria do të veprojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi, me aktin e themelimit si dhe statutin e saj.

NENI 2

- 2.1 Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.
- 2.2 Shoqëria do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesit të saj (ortaku i vetëm) në kapitalin themeltar.

NENI 3

- 3.1 Shoqëria "**Konfident**" Sh.p.k, ka selinë e saj në adresën "Rruga Mine Peza", lloji apartament me sipërfaqe 125 m2 me Nr Pasurie 2/444-N7, Zona Kadastrale 8350, Volumi 23, Faqa 204. Tiranë.
- 3.2 Trasferimi i Selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i vetëm).
- 3.3 Ajo mund te vendosi hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të Asamblesë së përgjithshme (Ortaku i vetëm).

NENI 4

- 4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë "**Konfident**" sh.p.k., është me një afat të pacaktuar.
- 4.2 Ajo mund të prishet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i vetëm) ose sipas përcaktimeve në Statut.



KONFIDENT

Rr.Mine Peza
Tel.+355 04 22 14 800
www.konfident.al
E-mail: info@konfident.al

NENI 5

5.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **"Konfident"** sh.p.k.:

- Veprimtari të medias së të gjitha llojeve. Aktivitet në fushën e mediave elektronike dhe të shkruar, botime të ndryshme, prodhim e publikim reklamash, tregtim pajisjesh për nevojat e mediave elektronike.
- Krijimi i gazetës.
- Kryerjen e shërbimeve dhe dërgesave postare.
- Krijimi i platformave online dhe jo-online.
- Prodhim dhe publikim reklamash.

NENI 6

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"Konfident"** sh.p.k është në para me vlerë 100. 000 (një qind mijë leke).

6.2 Kapitali themeltar është tërësisht i nënshkruar dhe do të shlyhet nga Ortaku i vetëm i shoqërisë në momentin që kompania do të zotërojë llogaritë e saj bankare.

6.3 Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i Ortakut të vetëm në vlerën 100. 000 (një qind mijë leke) ose 100 % të kapitalit themeltar.

NENI 7

7.1 Kapitali i shoqërisë **"Konfident"** sh.p.k., mund të zmadhohet ose zvogëlohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (ortakut i vetëm), por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

8.1 Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë sipas parashikime të Statutit.

NENI 9

9.1 Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje **"Konfident"** sh.p.k., Tiranë, Shqipëri .

NENI 10

10.1 Organet Vendimarrëse dhe Drejtuese të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"Konfident"** sh.p.k., janë:

- Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm)
- Administratori që zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm)

10.2 Fusha e veprimit, përbërja, organizimi dhe mënyra e funksionimit e organeve rregullohet në statut.

NENI 11



KONFIDENT

Rr.Mine Peza
Tel.+355 04 22 14 800
www.konfident.al
E-mail: info@konfident.al

11.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"Konfident"** sh.p.k.
Z. KRISTI DUSHI.

11.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë do ti besohet Administratorit Z. KRISTI DUSHI.

11.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e parashikuara nga ligji Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe statuti i shoqërisë tregtare.

11.3 Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të shoqërisë deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sipas ligjit për Q.K.R.

11.4 Administratori është i autorizuar të firmosi të gjitha aktet dhe te marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë të delegojë kompetencat e tij personave të tretë.

NENI 12

12.1 Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i shpërndahet ortakëve (Ortaku i vetëm) në përpjestim me kontributin e tij në kapitalin themeltar, pasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet që ka shoqëria.

NENI 13

13.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"Konfident"** sh.p.k. dhe të tretëve do të zgjidhen me pajtim.

13.2 Në mungesë të pajtimit mosmarrëveshjet do të zgjidhen sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 14

14.1 Akti i themelimit u perpilua në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

14.2 Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga Ortaku i vetëm.

ORTAKU I VETËM

KRISTI DUSHI

Kristi Dushi